



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Në bazë të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji nr. 04/L-226, (neni 28, paragrafi (1,2), neni 35 paragrafi (2), neni 36, neni 54 paragrafi 1.3 dhe 1.9 dhe neni 55, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar dhe Konkluzionit për Fillimin e Procedurës për Vlerësimin e Lejimit të Përqendrimit, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e datës 6 KORRIK 2017 mori këtë:

V E N D I M

- I. **LEJOHET**, Përqendrimi I Realizuar, ndërmjet përfitimit të kontrollit të British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited (BAT WECTL) mbi/të Bulgar Tabac Holding AD dhe filialeve të tyre.
- II. Nuk vërehen shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të Pozitës Dominuese, sipas Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- III. **Parashtruesi i Njoftimit për Përqendrim** obligohet të paguaj Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me Nenin 20 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja (tremijë euro).
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit të Komisionit.

A R S Y E T I M

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim dhe plotësimit të lëndës (Nr.prot.90/17-02/H), e paraqitur në bazë të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji nr. 04/L-226, (neni 28, paragrafi (1,2), neni 35 paragrafi (2), neni 36, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të